



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:093640  
Datë: 21.08.2024  
Numri i dokumentit: 06072357

AC.nr.3594/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nehat Idrizi kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Burim Shala anëtar të kolegjit, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit U. A., nga fsh T... K-Pejës, te cilin e përfaqëson i autorizuari O. L., avokat në Pejë kundër të paditurve E., Z., E. dhe E. H., qe te gjithë nga fshati T... K-Pejës të cilët i përfaqëson i autorizuari Adem Nikqi, avokat në Pejë, me bazë juridike vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.461/17 i datës 22.03.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET e bazuar ankesa e të autorizuarit të paditurit E. H., nga fshati T..., Komuna e Pejës, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.461/17 i datës 22.03.2021, dhe çështja i kthehet në rivendosje të njëjtës gjykatë.

**A r s y e t i m**

Gjykata e Themelore në Pejë, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.461/17 i datës 22.03.2021 ka vendosur si vijon: "... Vërtetohet se paditësi U. (A) A., është pronar nga baza e mbajtjes ne mirëbesim i pjesës se ngastrës kadastrale ... ZK –T. dhe atë sipas pikave : nga pika 1 deri ne piken 2 ne gjatësi prej ... metra nga pika 2 deri te pika 3 në gjatësi prej ... metra dhe nga pika tre deri te pika 1 ne gjatësia prej ... metra qe e përben sipërfaqen prej ... m2 dhe nga pika 5 deri te pika 6 ne gjatësi prej ... metër, nga pika 6 deri te pika 7 gjatësi ne ... metra nga pika 7 e deri ne piken 8 ne gjatësi ... metra dhe nga pika 8 deri te pika 5 ne gjatësi prej ... metra qe përben sipërfaqen pre ... m2.e në sipërfaqe të përgjithshme prej ... m2. Detyrohen te paditurit E., Z., E. dhe E. H., qe si trashëgimtarë te rendit te parë ligjorë te te ndjerit Gj. (F) H., ti njohin këtë te drejtë paditësit U. A., dhe te lejojnë qe kjo te regjistrohet ne emër te paditësit ne zyrën komunale kadastrale ne Pejë ne afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit te aktgjykimit e nen kërcenim të

përmbartimit me dhunë. Detyrohen të paditurit që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajnë shumën prej ... euro në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit e në kërcënim të përmbartimit me dhunë...”.

Kundër këtij aktvendimi i padituri në afat ligjor më datë 06.04.2021 ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale të LPK-së, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e të paditurit dhe të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të hudhet poshtë padia e paditësit U. A., si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, me propozim që ankesa e të paditurit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi U. A. nga fsh T..., Komuna e Pejës, më datë 12.05.2017 ka paraqitur padi për pengim posedimi dhe propozim për caktimin e masës së përkohshme kundër të paditurit E. H., nga fshati T..., Komuna e Pejës.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar këto prova: është lexuar kontrata interne në dorëshkrim i dt ..., shiqohet kopja e planit të ngastrave ..., ortofoto, është shikuar certifikata e pronësisë lëshuar me dt ... të ngastrave ... ZK-Pejë, certifikate e vdekjes së Gj. H., kopja e planit të ngastrave ... Dhe ... ZK- T..., certifikata e ngastrës ... ZK-T..., certifikata e ngastrës 73 ZK-T..., është bërë dalja e gjykatës në vend të ngjarjes me ekspert të gjeodezisë me dt 22.03.2019 është lexuar ekspertiza e ekspertit F. H., 22.03.2019 dhe në seancën e fundit është nxjerr si prove certifikata e pronësisë e ngastrës ... të dt 19.02.2021. Gjithashtu për vërtetimin gjendjes faktike ka bërë dëgjimin e dëshmitareve S. B. dhe S. Sh. të cilët janë dëgjuar në seancën e dt 15.09.2020, është lexuar deklarata e M. K. dhënë të noteri B. S., me dt 07.07.2020 si dhe janë dëgjuar në cilësi të palëve paditësi U. A. dhe i padituri E. H., e të cilët janë dëgjuar në seancën e datës 28.01.2021.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes tani për tani nuk mund të pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Deri të këto shkelje ka ardhur si pasojë e faktit se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore. Pasi që të kontestet e pengimit të posedimit paditësi nuk ka mundësi ta ndryshoj objektin e kontestit ashtu siç ka vepruar paditësja gjegjësisht

si e ka lejuar gjykata ndryshimin.

Siç del nga shkresat e lëndës paditësi, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për shkak të pengimit të posedimit kundër të paditurit. Dhe ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri E. (H) Gj., e ka penguar paditësin ne posedimin e fundit ne paluajtshmerin e ti ne ngastrën katastrale ... dhe një pjese te ngastrës ... duke kërkuar qe te pamundëson shfrytëzimin e paluajtshmeris te cilën e ka ne posedim paditësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e lejimit të ndryshimit të padisë në kuptimin objektiv ( objekti i kontestit ) nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 257 lidhur me nenin 478, 479 dhe 480 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë është dashur të jetë më e kujdesshme me rastin e vendosjes për propozimin për ndryshimin e padisë duke marr parasysh faktin se kontesti është filluar me padi për shkak të pengimit të posedimit kontest ky i veçantë për të cilin vlejnjë rregulla të veçanta ligjore të parapara me kreun e XXVII të LPK-së.

Gjykata e Apelit vë në dukje se kur paditësi me padi kërkon mbrojtje gjyqësore nga akti i pengimit të posedimit ai mund ta ndryshoj kërkesën e tij , mund ta zmadhoj atë mirëpo ai nuk mund ta ndryshoj llojin e kontestit (të paraqes kërkesa të natyrës pronësore, kompensimit të dëmit apo servitutit ) por këto ndryshime duhet ti bëjë në kuadër të objektit të kontestit për shkak të pengimit të posedimit. Pra ai nuk mund të kaloj prej objektit të kontestit për shkak të pengimit të posedimit në kontest të natyrës tjetër siç është vepruar në rastin konkret. Gjykata e shkallës së parë nuk është dashur ta lejoj që të bëhet ndryshimi i tillë nga paditësi përkatësisht gjykata është dashur t, ia refuzoj propozimin për ndryshimin e objektit të kontestit prej pengimit të posedimit në kontest të vërtetimit të pronësisë. Ashtu që më pastaj është dashur të vazhdoi kontestin për shkak të pengimit të posedimit ashtu edhe siç është paraqitur padia.

Gjykata e Apelit nuk i shqyrtoi pretendimet tjera ankimore të palës, pasi që shkeljet e cekura më lartë janë të natyrës thelbësore për të cilën gjë çështja u desh të prishet.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë në rigjykim të ketë parasysh vërejtjet e lartë cekura të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë. Ti evitoj të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cekura më lartë. Në atë mënyrë që ti thërras palët ndërgjyqëse dhe të ua sqaroj konkretisht se nga padia e paditëses në rastin konkret kemi të bëjmë me procedurë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit ku janë të caktuara çështjet të cilat trajtohen në mënyrë specifike duke u kufizuar vetëm në konstatimin e të provuarit të fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë dhe se te këto konteste përjashtohet mundësia e shqyrtimit të çështjeve tjera. Nëse paditësja përkatësisht i autorizuar i saj kërkojnë prapë ndryshimin e objektit të kontestit gjykata e shkallës së parë duhet ta refuzoj një propozim të tillë ashtu që kontesti të vazhdoj vetëm për shkak të pengimit të posedimit duke përjashtuar shqyrtimin e çështjeve tjera. Ti administroj edhe provat e tjera e më pastaj të vendos për kërkesëpadinë e paditëses në bazë të ligjit.

Numri i lëndës: 2019:093640  
Datë: 21.08.2024  
Numri i dokumentit: 06072357

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3594/2021, datë 15.08.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

Nehat Idrizi d.v